

Programi teknik

A dëshiron të mësosh mbi rolin e teknikës në shoqëri?

A dëshiron të kombinosh teknikën me një interesim artistik dhe gjuhësor?

A dëshiron të punosh menjëherë pas gjimnazit, por sërish të keshë mundësi që t'i vazhdosh studimet?

A dëshiron të mësosh më tepër në lidhje me sipërmarrje?

A dëshiron të kualifikohesh në një lëmi ku nevojitet shumë personel?

Në atë rast, Programi për teknik mund të jetë për ty.

Te Programi teknik do të mësosh mbi zhvillimin e teknikës, nga ideja deri në produktin apo shërbimin e gatshëm. Do të mësosh të krijosh forma dhe marketing, dhe do të mësosh për ndikimin e produkteve të ndryshme te ambienti dhe te njerëzit. Pasi që teknika avancohet çdo herë e më tepër është me rëndësi që të mendosh se për çfarë do të mund të përdorim teknikën e re – dhe për çfarë nuk duhet ta përdorim atë.

Të punosh apo t'i vazhdosh studimet

Programi teknik mund të përshtatet. Nëse nxënësit dëshirojnë që programi teknik t'i përgatis për shkollim në universitet apo fakultet, kjo gjë mund të rregullohet. Nëse nxënësit përndryshe dëshirojnë që programi t'i përgatis për punë menjëherë pas gjimnazit edhe kjo gjë mund të rregullohet.

Nëse zgjedh që t'i vazhdosh studimet mund të kërkoresh të pranohesh në fakultet apo universitet ose në Fakultetin e profesioneve. Në atë rast mund për shembull të bëhesh teknik i aeroplanëve ose teknik i sistemeve të makinave. Nëse ke zgjedhur të ndjekësh Programin teknik me një drejtim estetik ndoshta do të mundesh të vazhdosh studimet te fakultetet artistike.

Punë ku mund të pranohesh

Ekzistojnë punë të cialt mund t'i kërkoresh menjëherë pas kohës te Programi teknik. Mundesh për shembull të shesësh mallra ose të ndihmosh klientët në një butikë me drejtim teknik. Mundesh poashtu edhe të punosh në industrinë e prodhimeve.

Përmbajtja e Programit

Programi teknik përbëhet prej kurseve. Disa kurse janë obligatorike për të gjithë ata që studiojnë në gjimnaz. Kurset e tjera janë të veçanta për Programin teknik. Disa nga kurset do të mund t'i zgjedhësh vetë.

Programi nuk ka drejtimeve ndërkombëtare. Në vend të tyre, çdo shkollë ka mundësi që të krijojë drejtimet e veta. Shembull për drejtimet janë krijimi i formave, teknikë informacioni, teknik rrjeti, arkitekturë, teknikë, drejtim sipërmarrjesh, teknikë prodhimi, ndërtim ambiental dhe shoqëror, komunikacion, elektronikë dhe bioteknikë.

Ti ndoshta ke ndonjë interesim të veçantë për të cilin mund të jetë e mundur të studijosh në një vend tjetër? Pyete udhërrëfyesin tënd të studimeve dhe të profesioneve në rast se drejtimi

është i përfshirë te programi shtetëror. Në atë rast do të keshë mundësi që të pranohesh tek drejtimi.

Kontakte me tregun e punës

Te Programi teknik nuk ka kualifikim në vende të punës (APU) por ka mundësi që të provosh të punosh gjatë kohës në gjimnaz. APU-në tënde e planifikon shkolla në bashkëpunim me vende të lira të punës aty ku banon ti. Kjo është një mënyrë e mirë që të krijosh kontakte të cilat mund t'i përdorësh kur do të kërkosh punë. Nëse të intereson ta bësh APU-në tënd në një vend tjetër përveç Suedisë, kjo mundësi do t'ju jepet.

Ardhmëri dhe punë

Ke mundësi të mira që të punësoshesh pas studimeve të tua te Programi teknik, sidomos në rast se zgjedh t'i vazhdosh studimet në universitet apo fakultet. Tani shkollohen shumë më tepër teknik. Kompani në të gjitha vendet e botës kanë nevojë për personel me dituri teknike.